



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.16, datë 28.04.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
ELBASAN SH.A.

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*Ligji nr. 8102*), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (*VKM nr.958*), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (*Rregullore e licencimit*),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.04.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.",

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a me shkresën nr.425 prot. datë 13.03.2023 dhe e-mail për plotësim dokumentacioni me datë 31.03.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (*ERRU*) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (*KKRR*) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (*VKM nr. 302*).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi:

- a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a (NUIS M23322201V) është themeluar më datë 19.09.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe Bashkitë Elbasan me 28.52%, Cërrik me 5.46%, Gramsh me 4.13%, Belsh me 4.42%, Librazhd me 3.13%, dhe Peqin me 3.34%.
 - b) Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 257 351 banorë të Bashkive Elbasan, Cërrik, Gramsh, Belsh, Librazhd dhe Peqin.
 - c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Julian Doçi është diplomuar në Universitetin Politeknik në Inxhinieri hidroteknike në vitin 2011 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a me (NUIS M23322201V), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;
2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Luan Tabaku
 - b) Drejtues Teknik – Julian Doçi

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a janë Bashkitë Elbasan, Cërrik, Gramsh, Peqin, Belsh, Librazhd.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a për marrjen e këtij vendimi.
7. Vendimi i KKRR nr.26, datë 31.05.2019 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.55, datë 28.10.2019 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.158, datë 30.12.2020 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Belsh sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.345, datë 21.09.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.389, datë 21.10.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Gramsh sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.430, datë 11.11.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Cërrik sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani